

ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Paraqes një ankesë kundër:

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Zyra e Prokurimit

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr1 i prokurimit	214-25-11592-5-5-8
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me inventar per nevojat e MPB-se.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

“MOBELLAND” SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga “Xhavit Sylja” p.n.

(Adresa)

(Vendi): Suharekë

(Kodi postar): 23 000

044 606 379

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it) /

Ardian Morina

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@mobelland.net

(Adresa elektronike)

06.02.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

Autoriteti Kontraktues MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME ka publikuar njoftimin për ftesë për ofertim e korigjuar për prokurimin me titull: Furnizim me inventar për nevojat e MPB-se. me datë: 05.02.2026 15:24. Afati i kërkesës për sqarimin e tenderit është deri me datën 06.01.2026. Afati i fundit për dorëzimin e tenderit është me 09.02.2026, në ora 14:00:00 Ne me datë: 05.02.2026 kemi paraqitur kërkesën për heqjen e kriterve diskriminuese.

Vendimin për refuzim të kërkesës për heqjen e kriterve diskriminuese e kemi pranuar me datën: 06.02.2026 13:50

Kriteri për dhënie të kontratës ka qenë tendei i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Nuk kemi marrë pjesë në hapjen e tenderit, por me qenë se procesverbali na është dërguar përmes platformës elektronike nuk kemi pasur ndonjë vërejtje.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

Njoftimin si tenderues i eliminuar e kemi marrë në vendimin e AK-s B58 të publikuar me datë

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☐

Jo ☒

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Duke u bazuar në Ligjin për Prokurimin Publik në Kosovë me nr. 04/L-042 , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 mendojmë që Autoriteti kontraktues i ka shkelur dispozitat e LPP-së si në vijim:

Neni 1 i LPP-së

Neni 6 të LPP-së

Neni 7 të LPP-së

Neni 28 të LPP-së

Neni 51 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 65 i LPP-së

Neni 4 i Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 6 i Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 7 i Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 9 i Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 10 i Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 21 i Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 22 i Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 40 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti kontraktues **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME** ka publikuar njoftimin për kontratë me titull: Furnizim me inventar për nevojat e MPB-se, me nr. të prokurimit: **214-25-11592-5-5-8**.

Pasi kemi shkarkuar njoftimin, kemi parë që Autoriteti Kontraktues ka paraqitur disa kërkesa të kualifikimit të cilat haptas favorizojnë ndonjë operator ekonomik të paracaktuar pasi që të njejtat nuk janë në përputhje me dispozitat ligjore të legjislacionit të prokurimit sepse kërkesat nuk janë relevante me natyrën e procedurës së prokurimit në fjalë si dhe bien ndesh me procedurën e mini tenderimit.

Pra tek IV.6) Formulari i Tenderit dhe numri i ekzemplareve të Tenderit dhe Lista e Dokumenteve të kërkuara tek kërkesa E. është kërkuar që Me rastin e ofertimit, operatorët ekonomik, duhet të sjellin katalogët ose broshura prej prodhuesit për pajisjet që oferton. Katalogët ose broshurat, duhet të jenë të shoqëruara me përshkrim të detajuar të specifikimeve teknike për secilin lloje të pajisjes që oferton. Nëse katalogu përfshin më shumë modele, ju duhet të nënvizoni (shënjon) modelin me të cilin ofertoni.

E.Kriteri sipas të cilit operatorët ekonomikë, me rastin e ofertimit, janë të obliguar të dorëzojnë **katalogë ose broshura vetëm nga prodhuesi**, të shoqëruara me përshkrim të detajuar teknik dhe shënjim të modelit të ofertuar, **duhet të hiqet menjëherë**, pasi është vendosur në kundërshtim të plotë me kornizën ligjore të prokurimit publik sipas Ligjit për Prokurimin Publik dhe rregullave në fuqi, **Autoriteti Kontraktues nuk ka të drejtë të vendosë kritere apo kërkesa shtesë për kualifikim dhe dëshmi**, përveç atyre që janë të paracaktuara dhe të standardizuara nga AQP (Agjencia Qendrore e Prokurimit). Vendosja e këtij kriteri përbën:

- **tejkallim të kompetencave ligjore të Autoritetit Kontraktues,**
- cenim të parimit të sigurisë juridike,
- shkelje të drejtpërdrejtë të parimit të trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së lirë.

Ky kriter nuk është i paraparë nga AQP si kërkesë standarde dhe nuk është i domosdoshëm për vlerësimin e përputhshmërisë teknike, pasi përshkrimi teknik i produktit mund të vërtetohet edhe përmes dokumentacionit ekuivalent, deklaratave teknike apo katalogëve të përgatitur nga operatori ekonomik për më tepër, kërkesa që dokumentacioni të jetë **ekskluzivisht nga prodhuesi** është kufizuese, përjashtuese dhe diskriminuese, pasi përjashton operatorë ekonomikë që veprojnë ligjërisht si distributorë, furnizues ose prodhues me porosi, pa asnjë justifikim teknik apo ligjor. Për këto arsye, ky kriter është **i paligjshëm në thelb**, nuk prodhon efekt juridik dhe **duhet të largohet menjëherë nga Dosja e Tenderit**.

Tek IV.6) Formulari i Tenderit dhe numri i ekzemplareve të Tenderit dhe Lista e Dokumenteve të kërkuara tek kërkesa F. është kërkuar që OE duhet të ketë dhe dorëzojë autorizim nga prodhuesi për artikujt 1 -16.

F. Kriteri sipas të cilit **operatori ekonomik duhet të ketë dhe të dorëzojë autorizim nga prodhuesi për**

artikujt 1–16 është i paligjshëm, diskriminues dhe në kundërshtim të drejtpërdrejtë me kornizën ligjore të prokurimit publik, prandaj duhet të hiqet menjëherë nga Dosja e Tenderit sipas Ligjit për Prokurimin Publik dhe rregullave të zbatueshme, Autoriteti Kontraktues nuk ka kompetencë të vendosë kritere apo kërkesa shtesë për kualifikim, përveç atyre që janë të standardizuara dhe të përcaktuara nga AQP (Agjencia Qendrore e Prokurimit). Vendosja e këtij kriteri përbën tejkalim të kompetencave ligjore të Autoritetit Kontraktues.

Kërkesa për autorizim nga prodhuesi:

- kufizon pjesëmarrjen vetëm te operatorët ekonomikë që kanë marrëdhënie të drejtpërdrejta ose ekskluzive me prodhuesin,
- përjashton operatorë ekonomikë që veprojnë ligjërisht si distributorë, furnizues, tregtarë apo prodhues me porosi,
- nuk është e domosdoshme për garantimin e cilësisë, pasi cilësia dhe përputhshmëria teknike mund të vërtetohen përmes mjeteve tjera ligjore.

Në procedura të furnizimit me inventar dhe mobilje zyre, autorizimi nga prodhuesi **nuk është kriter i paraparë nga AQP**, nuk përbën kërkesë standarde dhe **nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e kontratës.**

Vendosja e këtij kriteri cenon drejtpërdrejt:

- parimin e konkurrencës së lirë,
- parimin e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit,
- parimin e proporcionalitetit dhe sigurisë juridike.

Për këto arsye, ky kriter është **i pavlefshëm juridikisht**, nuk prodhon efekt ligjor dhe **duhet të hiqet menjëherë**, duke qenë se **nuk lejohet vendosja e kritereve tjera përveç atyre të përcaktuara nga AQP.**

Tek IV.6) Formulari i Tenderit dhe numri i ekzemplareve të Tenderit dhe Lista e Dokumenteve të kërkuara tek kërkesa G. Është kërkuar që Prodhuesi duhet të jetë i certifikuar për standardet EN-1335-1, EN-1335-2 dhe EN-16139. Instituti – lëshuesi i Certifikatave për Standarde duhet të jetë i shtetit anëtar i Komitetit Evropian të Standardizimeve.

G. Autoriteti Kontraktues ka paraparë kriterin sipas të cilit **prodhuesi duhet të jetë i certifikuar për standardet EN-1335-1, EN-1335-2 dhe EN-16139**, si dhe ka kërkuar që instituti lëshues i certifikatave të jetë nga një shtet anëtar i Komitetit Evropian të Standardizimeve (CEN). Ky kriter është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Ligjin për Prokurimin Publik, me aktet nënligjore përkatëse dhe me kompetencat ligjore të Autoritetit Kontraktues, dhe për këtë arsye **duhet të hiqet menjëherë nga Dosja e Tenderit.**

Tejkalim i kompetencave ligjore të Autoritetit Kontraktues sipas Ligjit për Prokurimin Publik dhe rregullave zbatuese, **Autoriteti Kontraktues nuk ka të drejtë të vendosë kritere shtesë për kualifikim teknik apo profesional, përveç atyre që janë të përcaktuara, të standardizuara dhe të lejuara nga AQP (Agjencia Qendrore e Prokurimit).**

Vendosja e këtij kriteri për certifikim EN të prodhuesit përbën:

- tejkalim të kompetencave ligjore të Autoritetit Kontraktues,
- shkelje të parimit të ligjshmërisë dhe sigurisë juridike,

- devijim nga standardet e unifikuara të përcaktuara nga AQP.

Ligji **ndalon shprehimisht vendosjen e kriterëve tjerë**, përveç atyre të parashikuara nga AQP, pikërisht për të parandaluar praktikën kufizuese, selektive dhe diskriminuese në procedurat e prokurimit publik.

Pra ka është Mospërputhje e plotë me objektin e kontratës pasi që procedura në fjalë ka për objekt **furnizimin me inventar dhe mobilje zyre**, që përfshin një gamë të gjerë artikujsh të ndryshëm. Standardet EN-1335-1, EN-1335-2 dhe EN-16139:

- lidhen kryesisht me **karrige dhe ulëse**,
- nuk aplikohen në mënyrë universale për tavolina, dollapë, recepsione, kuzhina, raftë, mobilje të fiksuara apo inventar tjetër,
- nuk janë të dizajnuara për të vlerësuar të gjithë artikujt e përfshirë në këtë procedurë.

Kërkimi i këtyre certifikimeve për **të gjithë prodhuesit**, pavarësisht nga natyra e artikujve, është i **pajustificuar teknikisht** dhe nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me objektin real të kontratës. Certifikim i prodhuesit, jo i produktit – kriteri i gabuar në thelb një problem themelor i këtij kriteri është fakti që **certifikimi kërkohet për prodhuesin, dhe jo për produktin konkret që ofertohej**.

Në prokurimin publik, vlerësimi teknik duhet të fokusohet në:

- përputhshmërinë e produktit me specifikimet teknike,
- cilësinë dhe funksionalitetin e artikullit të ofertuar,
- jo në statusin formal apo certifikimin e përgjithshëm të prodhuesit.

Kjo e bën kriterin **të shkëputur nga qëllimi i tij i supozuar**, dhe e shndërron atë në një mjet kufizues për konkurrencën, jo në një mjet verifikimi cilësie. Kufizim gjeografik indirekt dhe diskriminim

Kërkesa që **instituti certifikues të jetë nga një shtet anëtar i CEN** përbën **kufizim gjeografik indirekt**, i cili është i ndaluar nga Ligji për Prokurimin Publik.

Kjo kërkesë:

- përjashton prodhues dhe operatorë ekonomikë që kanë certifikime ekuivalente nga institucione të tjera të njohura ndërkombëtarisht,
- kufizon konkurrencën vetëm në një treg të ngushtë,
- nuk është e domosdoshme për garantimin e cilësisë.

Ligji kërkon pranimin e **dëshmimeve ekuivalente**, ndërsa ky kriter e përjashton këtë mundësi. Cenimi i parimeve themelore të prokurimit publik vendosja e këtij kriteri cenon drejtpërdrejt:

- **parimin e konkurrencës së lirë dhe efektive**,
- **parimin e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit**,
- **parimin e proporcionalitetit**,
- **parimin e sigurisë juridike**.

Në veçanti, kombinimi i këtij kriteri me kriterë të tjerë kufizues e bën procedurën joproporcionale dhe selektive, në kundërshtim me qëllimin e Ligjit për Prokurimin Publik. Përfundim dhe kërkesë e qartë për të gjitha arsyet e lartcekura, kriteri sipas të cilit **prodhuesi duhet të jetë i certifikuar me standardet EN-**

1335-1, EN-1335-2 dhe EN-16139, si dhe kërkesa për institutin certifikues nga shtet anëtar i CEN:

- është i paligjshëm në thelb,
- është **diskriminues dhe joproporcional**,
- nuk është i lejuar sipas kompetencave të Autoritetit Kontraktues,
- nuk është i paraparë nga AQP.

Për këtë arsye, **ky kriter duhet të hiqet menjëherë nga Dosja e Tenderit.**

Tek IV.6) Formulari i Tenderit dhe numri i ekzemplareve të Tenderit dhe Lista e Dokumenteve të kërkuara tek kërkesa H. Është kërkuar që Para hapjes së ofertave duhet të dorëzohen mostrat për artikujt 6,7,8,9.

H. Autoriteti Kontraktues ka paraparë kriterin sipas të cilit **para hapjes së ofertave duhet të dorëzohen mostrat për artikujt 6, 7, 8 dhe 9.** Ky kriter është i paligjshëm, joproporcional dhe në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Ligjin për Prokurimin Publik, si dhe me rregullat dhe kompetencat e përcaktuara nga AQP (Agjencia Qendrore e Prokurimit), prandaj **duhet të hiqet menjëherë nga Dosja e Tenderit** tejkallim i kompetencave ligjore të Autoritetit Kontraktues sipas Ligjit për Prokurimin Publik dhe akteve nënligjore përkatëse, **Autoriteti Kontraktues nuk lejohet të vendosë kritere shtesë procedurale apo dëshmi kualifikuese**, përveç atyre që janë të standardizuara dhe të përcaktuara nga AQP Kriteri për dorëzimin e mostrave **para hapjes së ofertave** nuk është kriter standard i paraparë nga AQP për procedurat e furnizimit dhe përbën:

- tejkallim të kompetencave ligjore të Autoritetit Kontraktues,
- shkelje të parimit të ligjshmërisë dhe sigurisë juridike,
- devijim nga rregullat unifikuese që synojnë barazi dhe konkurrencë reale.

Ligji e ndalon shprehimisht vendosjen e kritereve të tilla shtesë, pikërisht për të parandaluar praktikën diskriminuese dhe selektive në procedurat e prokurimit publik shkelje e rëndë procedurale dhe cenim i barazisë dorëzimi i mostrave **para hapjes së ofertave** përbën **shkelje serioze të parimeve procedurale**, pasi:

- imponon barrë financiare dhe logjistike të panevojshme mbi operatorët ekonomikë,
- favorizon operatorë që kanë stok të gatshëm ose kapacitete të menjëhershme,
- penalizon operatorë që prodhojnë me porosi ose furnizojnë sipas kërkesës.

Kjo krijon një **avantazh të padrejtë konkurrues** dhe cenon barazinë mes operatorëve ekonomikë, në kundërshtim të drejtpërdrejtë me parimin e trajtimit të barabartë. Mostrat nuk janë kriter kualifikim paraprak në praktikën e konsoliduar të prokurimit publik, **mostrat nuk përbëjnë kriter për kualifikim paraprak** dhe nuk duhet të kërkojnë para hapjes së ofertave mostrat, nëse janë të domosdoshme, kërkojnë zakonisht:

- vetëm pas vlerësimit paraprak të ofertave,
- vetëm nga operatori ekonomik i renditur i pari,
- vetëm për verifikim përfundimtar të përputhshmërisë teknike.

Kërkesa për mostra në fazën paraprake **e deformon procesin e vlerësimit**, duke e zhvendosur fokusin nga dokumentacioni ligjor dhe teknik në elemente jashtë rendit procedural përmban mospërputhje me natyrën e procedurës – mini-tender për furnizim

Procedura në fjalë është **mini-tender për furnizim**, e cila, sipas qëllimit ligjor, duhet të jetë:

- e thjeshtuar,
- e shpejtë,
- e bazuar në dokumentacion standard.

Vendosja e kërkesës për dorëzim mostrash para hapjes së ofertave e shndërron këtë procedurë në një proces të rënduar, më kompleks sesa një tender i hapur, duke shkelur logjikën dhe qëllimin e mini-tenderit si dhe është bërë edhe cenimi i parimeve themelore të Ligjit për Prokurimin Publik ky kriter cenon drejtpërdrejt:

- **parimin e konkurrencës së lirë dhe efektive,**
- **parimin e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit,**
- **parimin e proporcionalitetit,**
- **parimin e transparencës dhe sigurisë juridike.**

Vendosja e këtij kriteri nuk është e nevojshme, nuk është e justifikuar dhe nuk sjell asnjë vlerë të shtuar për vlerësimin teknik të ofertave andaj kërkojmë për të gjitha arsyet e lartcekura, kriteri sipas të cilit **mostrat për artikujt 6, 7, 8 dhe 9 duhet të dorëzohen para hapjes së ofertave** është:

- i paligjshëm,
- i pavlefshëm juridikisht,
- në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik dhe kompetencat e AQP-së.

Për këtë arsye, **ky kriter duhet të hiqet menjëherë nga Dosja e Tenderit**, pasi **ligji ndalon shprehimisht vendosjen e kritereve tjera përveç atyre të përcaktuara nga AQP.**

Përtej shkeljeve konkrete dhe të detajuara të kritereve të veçanta të Dosjes së Tenderit, kombinimi dhe natyra e tyre ngritin **dyshim serioz dhe të arsyeshëm për kurdisje të procedurës së prokurimit.**

Vendosja e njëkohshme e kritereve që:

- nuk janë të parashikuara nga AQP,
- janë të ndaluara nga Ligji për Prokurimin Publik,
- tejkalojnë kompetencat e Autoritetit Kontraktues,
- dhe kufizojnë në mënyrë të dukshme rrethin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës,

nuk mund të konsiderohet si gabim procedural apo neglizhencë administrative.

Në veçanti, kërkesat për:

- autorizim nga prodhuesi,
- certifikime specifike EN për prodhuesin,
- dorëzim mostrash para hapjes së ofertave,
- dhe dokumentacion ekskluziv nga prodhuesi,

të marra së bashku, **nuk janë të rastësishme**, por krijojnë një strukturë kriteresh që objektivisht **favorizon një numër shumë të kufizuar operatorësh ekonomikë**, në dëm të konkurrencës së lirë dhe trajtimit të

barabartë.

Ligji për Prokurimin Publik dhe rregullat e AQP-së janë ndërtuar pikërisht për të parandaluar situata të tilla, ku përmes vendosjes së kriterëve të palejuara synohet orientimi i procedurës drejt operatorëve të caktuar. Devijimi nga këto rregulla **minon besimin në integritetin e procedurës** dhe cenon parimet themelore të transparencës dhe konkurrencës.

Për këtë arsye, ekziston **dyshim i bazuar se kriteret në fjalë janë vendosur me qëllim të paracaktimit të rezultatit të procedurës**, gjë që e bën të domosdoshëm rishqyrtimin e plotë të Dosjes së Tenderit dhe largimin e menjëhershëm të të gjitha kriterëve të paligjshme.

Si dhe shkelja tjetër e bere nga ju si AK është Afati i dorëzimit të ofertave

Autoriteti Kontraktues nuk ka siguruar afat të mjaftueshëm për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertave, duke mos e zgjatur në mënyrë të arsyeshme afatin për dorëzim të tenderit pas publikimit të dokumentacionit të korrigjuar më datë 05.02.2026 dhe afati për dorëzimin e tenderit është 09.02.2026 pra dokumentacioni i korrigjuar është publikuar më datë 05.02.2026 në ora 15:24, ndërsa afati për dorëzim të ofertave është caktuar më 09.02.2026 në ora 14:00.

Ky interval kohor është në mënyrë evidente i pamjaftueshëm dhe përbën shkelje serioze procedurale sipas parimeve themelore të Ligjit për Prokurimin Publik. Vendosja e një afati kaq të shkurtër, veçanërisht pas publikimit të korrigjimeve në dokumentacion, cenon drejtpërdrejt: Nenin 1 të LPP-së – sigurimin e përdorimit efektiv të fondeve publike përmes konkurrencës reale

Nenin 6 të LPP-së – parimin e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit

Nenin 7 të LPP-së – parimin e proporcionalitetit

Nenin 28 të LPP-së – detyrimin për zhvillimin e procedurës në mënyrë transparente dhe konkurruese

Afati i lënë në dispozicion operatorëve ekonomikë nuk është proporcional me kompleksitetin e kërkesave të tenderit, të cilat përfshijnë përgatitje teknike, sigurim ofertash nga furnitorë, dokumentacion prodhuesish, katalogë dhe përmbushje administrative. Në praktikë, ky afat kufizon pjesëmarrjen vetëm tek operatorët që kanë qenë të përgatitur paraprakisht, duke krijuar avantazh të padrejtë dhe duke deformuar konkurrencën.

Moszgjatja e afatit pas publikimit të dokumentacionit të korrigjuar përbën cenim të drejtpërdrejtë të barazisë në pjesëmarrje dhe krijon dyshim të bazuar për kufizim artificial të konkurrencës, gjë që bie ndesh me qëllimin dhe frymën e ligjit të prokurimit publik.

Për këto arsye, kjo situatë konsiderohet shkelje materiale procedurale dhe kërkojmë zgjatjen e menjëhershme të afatit për dorëzim ofertash në mënyrë që të sigurohet konkurrencë reale, transparente dhe e barabartë.

Afati i lënë në dispozicion operatorëve ekonomikë është objektivisht i pamjaftueshëm për analizimin e dokumentacionit, për sigurimin e ofertave nga furnitorët, përgatitjen e dokumentacionit teknik dhe financiar, si dhe përmbushjen e kërkesave administrative të procedurës.

Moszgjatja e afatit cenon drejtpërdrejt: parimin e konkurrencës së lirë dhe efektive parimin e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit parimin e proporcionalitetit parimin e transparencës dhe sigurisë juridike.

Për këto arsye kërkojmë nga ju si Autoritet Kontraktues: Rishqyrtimin dhe anulimin e të gjitha kriterëve kufizues që tejkalojnë kushtet e marrëveshjes kornizë, Harmonizimin e dokumentacionit me parimet e barazisë në trajtim dhe konkurrencës së hapur, Zgjatjen e afatit për dorëzim ofertash, Njoftimin me shkrim

për vendimin lidhur me këtë kërkesë.

Shih fotot:

Ftesë për ofertim e korrigjuar - 05.02.pdf.pdf

content 2 / 20 100%

Numbri i Prokurimit: 214-25-11592-5-5-8 - Titulli: Furnizim me inventar për nevojat e MPB-së

TEMA: FTESË PËR OFERTIM për Furnizim me inventar per nevojat e MPB-se

Për: [shëno emrin dhe adresën e Operatorit Ekonomik]
I/E ndëruar: [shëno emrin e personit kontaktues]

Duke iu përgjigjur marrëveshjes për kontratë publike kornize , 214-25-11592-5-5-8 ne te cilën kompania e juaj është bere një nga palët e marrëveshjes, ftoheni që të ofertoni për kërkesat e detalizuara në Përshkrimin e Çmimit, Pjesa B të kësaj Ftese për ofertim "FPO". Ju lutem gjeni të bashkangjitur dokumentet, të cilat përbëjnë FPO.

Nga ju pritet që të ekzaminoni me kujdes të gjitha pjesët dhe seksionet e kësaj FPO dhe anekset e saj dhe të pajtohemi me të gjitha kërkesat, specifikimet dhe kushtet e përfshira këtu.

Oferta e juaj duhet të jete në përputhshmëri me këtë "FPO".

No, si Autoritet Kontraktues nuk pranojmë asnjë ndryshim.

Të gjitha shpenzimet që i bëni gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të ofertës nuk do të kompensohen dhe autoriteti kontraktues nuk do të ketë asnjë detyrim në rast se anulohet procedura.

Mirëpresim ofertën tuaj e cila duhet të dorëzohet në adresën e specifikuar në "Informacione për Tenderuesit", Pjesa A e kësaj FPO, para **09.02.2026 14:00:00**

Me dorëzimin e ofertës, tenderuesi, pranon plotësisht dhe pa kufizime kushtet e kontratës të përcaktuara në Pjesën B, Seksioni I-V të Dosjes së Tenderit si një bazë të vetme.


Mirëpresim pranimin e ofertës suaj.

Ju lutemi që të konfirmoni me shkrim pranimin e kësaj Ftese.

Sinqerisht,

Emri dhe mbiemri: "[shëno emrin dhe mbiemrin]"

Nënshkrimi: _____



Në mungesë të trajtimit të drejtë të kësaj kërkesë, rezervojmë të drejtën për vazhdimin e procedurave pranë organeve kompetente.

Për këtë arsye, ekziston dyshim i bazuar se kriteret në fjalë janë vendosur me qëllim të paracaktimit të rezultatit të procedurës dhe ky Tender I është pregaditur për OE Galenteria Podujevë pasi që ky OE ka pasur kontrata të negociuara nga ju si AK ku I njeiti ka bere dallavere me shtratrat te cilet jan vendosur ne Kampin BELVEDER pasi qe ka qen kontrat me qmime marramendëse te larta dhe ska qen procedur e hapur por e negociuar dhe ne baz te fakteve dhe provave te paraqitura ne kemi informacion te sigurt se ky OE pregadit tendere edhe ne AK tjera me keto specifika teknike dhe shperblehet me kontrat ku I njeiti shkel ligjin duke demtuar bugjetin e RKS dhe taksat e tatim pagueseve te Kosovës pasi qe I njeiti me keto mostra konkuron me qmimi mbi 50% me te larta se qmimi i OE ofertues dhe tjeret oe qe konkurojn dhe kanë qmim me te lire diskualifikohen pershkak te mostrave dhe ne kerkojm qe keto kriteret te cilat I keni vendosur te hiqen menjeher para afatit te dorzimit te tenderit dhe tu ipet shanc edhe OE tjer ne listen e ngusht te mini tendereve, gjë që e bën të domosdoshëm rishqyrtimin e plotë të Dosjes së Tenderit dhe largimin e menjëhershëm të të gjitha kriterëve të paligjshme.

Autoriteti Kontraktues ka detyrim ligjor të sigurojë që procedura të zhvillohet në mënyrë të paanshme, transparente dhe konkurruese. Mosveprimi në këtë drejtim do të rëndonte më tej dyshimet për kurdisje dhe do të cenonte ligjshmërinë e të gjithë procesit të prokurimit.

Andaj, Kërkojmë që në përputhje me dispozitat e LPP-së të lartcekura të heqni kriteret diskriminuese teknike të përzgjedhjes të cekura më lartë të cilat janë përfshirë në njoftim për kontratë dhe në dosjen e tenderit, lidhur me aktivitetin e prokurimit në fjalë si dhe të zgjatni afatin për dorëzimin e ofertave përndryshe jemi të detyruar që të paraqesim ankesë në OSHP dhe do të njoftojmë organet tjetër kompetente.

Pra nga te gjith veprimet e cituara me larte rezulton qarte se AK MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME dhe Zyrtari i Prokurimit: Agim Islami është vene ne lajthitje nga OE GALENTERIA PODUJEVË pasi qe Agim Islami vendos kritere diksriminuese te cilat AQP Agjencioni Qendror i Prokurimit i ndalon me ligj shprehimisht vendosjen e kritereve tjera përveç atyre të përcaktuara nga AQP dhe Agim Islami duke nxjerrur nje vendim per refuzim si e jashte afatshme Kërkesa për rishqyrtime e OE ANKUES MOBELLAND SH.P.K Rruga "Xhavit Sylaj" p.n. Suharekë te kerkeses per rishqyrtim pa i analizuar fare faktet dhe provat tona pasi qe ne ate vendim nuk jan analizuar fare pretendimet tona dhe duke mos e pezulluar lenden fare pra nga të gjitha veprimet e sipërpërmendura rezulton qartë se zyrtarët e prokurimit kan vendosur kritere të palejuara kan injoruar dispozitat e AQP-së kan cenuar parimet themelore të prokurimit public dhe kan zhvilluar procedurën në mënyrë selektive dhe jotransparente.

Këto veprime nuk mund të konsiderohen gabime teknike, por përbëjnë shkelje serioze profesionale dhe ligjore si dhe shkelje e Nenit 23 të LPP-së ku thot se Zyrtari i prokurimit është përgjegjës personalisht për ligjshmërinë e veprimeve të tij në procedure dhe Nenit 24 të LPP-së ku thot se Zyrtari i prokurimit duhet të veprojë në mënyrë profesionale, të paanshme dhe në përputhje me udhëzimet e AQP-së, Rregullorja e AQP-së për Certifikimin e Zyrtarëve të Prokurimit parashikon se certifikata e prokurimit revokohet në rast se zyrtari shkel rëndë Ligjin për Prokurimin Publik, vendos kritere të palejuara, cenon konkurrencën dhe trajtimin e barabartë, dëmton integritetin e procedurës Veprimet e zyrtarëve në këtë rast i plotësojnë të gjitha këto elemente andaj ne kerkojm nga ju si OSHP ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT qe të mirren masa per kete zyrtar te prokurimit Ta rekomandon dhe obligon AQP-në dhe organet tjera kompetente fillimin e procedurës për revokimin e certifikatës së prokurimit të zyrtarëve përgjegjës, për shkak të shkeljeve të rënda profesionale dhe cenimit të integritetit të procedurës së prokurimit publik.

Ky vendim është juridikisht i paqëndrueshëm, i nxjerrë në mënyrë blanco dhe përmban elemente që krijojnë dyshim serioz për shkelje të qëllimshme të legjislacionit të prokurimit publik. Vendim i paarsyetuar dhe i nxjerrë në mënyrë blanco. Vendimi nuk përmban analizë faktike dhe nuk specifikon bazën reale të llogaritjes së afatit. Nuk trajtohet pezullimi i procedurës, as zgjatja e afatit për dorëzim ofertash. Kjo përbën shkelje të standardeve minimale të arsyetimit administrativ dhe e bën vendimin arbitrar dhe të pavlefshëm në substancë. Manipulim procedural dhe përzjerje e datave Kërkesa për rishqyrtim është dorëzuar me datë 05.02.2026. Hapja e ofertave ishte planifikuar me 12.01.2026, mirëpo procedura ishte pezulluar për shkak të ankesës në OSHP. Pas vendimit të OSHP, Autoriteti Kontraktues ka zgjatur afatin për dorëzim ofertash deri më 09.02.2026. Kjo tregon qartë se data operative juridike e procedurës ishte 09.02.2026 dhe jo 12.01.2026. Përdorimi selektiv i datave të tejkaluara për të shpallur kërkesën jashtë afatit përbën: cenim të transparencës, devijim të procedurës, dyshim të bazuar për favorizim privat dhe manipulim të procesit.

Shkelja e detyrimit për pezullim pas dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim, procedura është dashur të pezullohej deri në trajtimin e saj mosveprimi në këtë drejtim cenon të drejtën për mjet juridik efektiv dhe barazinë e operatorëve ekonomikë përgjegjësi personale dhe dyshim për shkelje penale duke pasur parasysh mënyrën e trajtimit të kësaj çështjeje, ekziston dyshim serioz për tejkalim të kompetencave dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare nga personi përgjegjës për nxjerrjen e vendimit, Agim Islami

Për këtë arsye kërkojmë:

- shqyrtim për inicimin e përgjegjësisë penale nga organet kompetente
- inicimin e procedurës për revokimin e certifikatës së prokurimit
- shqyrtim disiplinor për shkelje të parimeve të prokurimit publik

Kërkojmë nga ju OSHP:

- Anulimin e vendimit për refuzimin e kërkesës si të jashtë afatshme
- Konstatimin se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor
- Trajtimin e kërkesës në themel
- Hetimin e mospërputhjes së datave dhe ndikimit në integritetin e procedurës
- Referimin e çështjes për përgjegjësi disiplinore dhe penale ndaj zyrtarit përgjegjës

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Duke pasur parasysh shkeljet të cilat i ka bërë Autoriteti Kontraktues si më lartë, neve do të na shkaktohen dëme materiale sepse për përgatitjen e tenderit janë bërë shpenzime të konsiderueshme si dhe fitimi i humbur për shkak se ne kemi ofruar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët në mesin e tenderuesve të përgjegjshëm për këtë tender pasi që të dy grupet tjera kanë ofruar tender të pa përgjegjshëm.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit."*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*